

## P E R K U J T I M E

## ANXHELO LEOTI

Në këtë e fundit u nda prej nesh albanisti i njohur i Bolonjës Anxhelo Leoti.

Anxhelo Leoti që në të ri iu kushtua me zell e dashuri të madhe studimit të gjuhës shqipe dhe botoi që heret disa vepra rreth saj. Më 1915 doli *Grammatica elementare della lingua albanese* (Dialecto Tosco), të cilën Norbert Jokli e ka çmuar si më të mirën gramatikë të dialektit toskërisht shkruar prej një të huaji. Një vit më vonë Leoti botoi librin e vëllimshëm *L'albanese parlato. — Cenni grammaticali, vocabolario, proverbi e dialoghi* (Shqipja e folur. — Shënime gramatikore, fjalor, proverbe e dialoge). Të dyja këto vepra, pa humbur aspak nga karakteri praktik e nga dobia që sjellin për të nxënë shqipen e për të njohur dhe mënyrat e shprehjes e proverbet e saj, me shtjellimin e lëndës e me spjegimet e fakteve gjuhësore nga pikëpamja e një njohësi të mirë të kësaj gjuhe, janë njëkohësisht dhe një kontribut i vlefshëm për studimet e gramatikës së shqipes.

Pas një pune gatitore shumëvjejtsh Leoti më 1937 botoi Fjalorin e tij shqip-italisht *Dizionario albanese-italiano*. Ky fjalor prej 1710 faqesh, të cilin e stolis një parathënie e Norbert Joklit, mbetet kryevepra e autorit të tij. Në këtë vepër lënda mbledhur prej fjalorësh të tjerë, prej veprash e shkrimesh të ndryshme të shqipes, prej shtypit të përditshëm, prej kumtimesh gojore etj., paraqitet shumë e pasur në krahasim me fjalorët e mëparmë. Një veçori e kësaj vepre është dhe frazeologjia, më të cilën është pajisur.

Me Anxhelo Leotin zhduket një lavrues i mirë i gjuhës shqipe, e sidomos një kërkimtar i palodhur i leksikut të saj, mbledhjes e përpunimit të së cilit ai i kushtoi një pjesë të madhe të jetës së tij. Me veprat që ka shkruar, ky dijetar e dashamirë i madh i gjuhës shqipe zë një vend të qendrueshëm në fushën e studimeve shqiptare.

E. Ç.

